


Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

Shkurt 2021

Tiranë, më 23 Mars 2021: Hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin shqiptar, në muajin Shkurt 2021, janë 360.524. Krahasuar me Shkurt 2020, ky tregues rezulton me rënie 41,5 %. Në Shkurt 2021, numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar është 158.173. Krahasuar me Shkurt 2020, ky numër ka rënë me 30,9 %. Numri i shtetasve të huaj të hyrë në Shqipëri gjatë dy muajve të parë të 2021 është 343.502, duke rënë me 28,2 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2020 (tab.1).

Gjatë dymujorit të parë të 2021, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Zvicra ka pasur rritjen më të madhe me 24,5 % dhe Kosova me 9,8 %, ndërsa uljen më të ndjeshme e ka pasur Greqia me 87,3 % dhe Anglia me 74,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020 (tab.2).

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri, Shkurt 2021



Për publikim 23/03/2021

Daljet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Shkurt 2021, janë 371.707 duke shënuar një rënie me 41,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Daljet e shtetasve shqiptarë nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Shkurt 2021, janë 228.953. Krahasuar me Shkurt 2020, ky numër ka rënë me 41,8 %. Daljet e shtetasve të huaj nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Shkurt 2021, janë 142.754. Krahasuar me Shkurt 2020, ky numër ka rënë me 42,0 %.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i Shqipërisë gjatë dy muajve të parë të 2021, është 500.637 duke rënë 45,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë (tab1).

Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj, Shkurt 2021

Periudha	Shkurt 2020	Shkurt 2021	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Shkurt 2020	Janar-Shkurt 2021	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrje gjithsej	616.496	360.524	-41,5	1.310.452	766.323	-41,5
Shqiptarë	387.555	202.351	-47,8	832.050	422.821	-49,2
Të Huaj	228.941	158.173	-30,9	478.402	343.502	-28,2
Dalje gjithsej	639.729	371.707	-41,9	1.482.423	822.288	-44,5
Shqiptarë	393.598	228.953	-41,8	924.663	500.637	-45,9
Të Huaj	246.131	142.754	-42,0	557.760	321.651	-42,3

Tab. 2 Hyrjet e shtetasve të huaj, Shkurt 2021

Shtetet	Shkurt 2020	Shkurt 2021	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Shkurt 2020	Janar-Shkurt 2021	Ndryshimi vjetor (%)
Kosovë	70.648	75.184	6,4	148.280	162.874	9,8
Maqedoni	34.230	27.688	-19,1	72.264	61.981	-14,2
Greqi	38.106	4.724	-87,6	76.849	9.742	-87,3
Itali	18.409	9.843	-46,5	39.476	19.772	-49,9
Angli	6.101	1.397	-77,1	11.660	2.946	-74,7
Mali i zi	27.337	20.686	-24,3	58.227	44.900	-22,9
Poloni	531	266	-49,9	1.077	489	-54,6
SHBA	3.218	1.803	-44,0	7.277	3.757	-48,4
Spanjë	497	197	-60,4	964	323	-66,5
Gjermani	3.024	1.608	-46,8	6.298	4.560	-27,6
Zvicër	1.234	1.167	-5,4	2.860	3.561	24,5
Të tjera	25.606	13.610	-46,8	53.170	28.597	-46,2
Gjithsej	228.941	158.173	-30,9	478.402	343.502	-28,2

Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit, Shkurt 2021

Periudha	Shkurt 2020	Shkurt 2021	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Shkurt 2020	Janar-Shkurt 2021	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrje Shtetas të Huaj	228.941	158.173	-30,9	478.402	343.502	-28,2
I. Personale	220.023	149.735	-31,9	462.216	328.855	-28,9
1. Pushime, vizitë tek të afërm, trajtim shëndetësor, etj.	210.915	143.618	-31,9	442.386	312.765	-29,3
2. Qëllime fetare	35	24	-31,4	73	68	-6,8
3.Udhëtarë transit	9.073	6.093	-32,8	19.757	16.022	-18,9
II. Biznes dhe profesionale	8.918	8.438	-5,4	16.186	14.647	-9,5

Tab. 4 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës udhëtimit, Shkurt 2021

Periudha	Hyrje gjithsej			Dalje gjithsej		
	Ajër	Det	Tokë	Ajër	Det	Tokë
Shkurt 2020	98.100	23.301	495.095	96.449	21.063	522.217
Shkurt 2021	35.422	16.705	308.397	36.832	14.302	320.573
Ndryshimi vjetor (%)	-63,9	-28,3	-37,7	-61,8	-32,1	-38,6
Janar- Shkurt 2020	213.130	49.040	1.048.282	228.590	69.772	1.184.061
Janar- Shkurt 2021	72.186	32.030	662.107	85.766	39.687	696.835
Ndryshimi vjetor (%)	-66,1	-34,7	-36,8	-62,5	-43,1	-41,1

Metodologjia

Qëllimi i publikimit të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë dhe pikave kufitare) është matja e disa treguesëve statistikorë që lidhen me turizmin.

Përkufizime

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Hyrjet janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet: Përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës. Një person që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti llogaritet çdo herë si një dalje e re.

Vizitor: Për qëllime të statistikave të turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për:

Qëllime personale të cilat grupohen në:

1. Pushime, vizitë tek të afërm, trajtim shëndetësor etj.;
2. Qëllime fetare;
3. Udhëtarë tranzit.

Kategoria e biznesit që përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë administrative dhe sigurohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (Policia e Shtetit, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit).

Të dhënat janë paraprake dhe subjekt rishikimi të vazhdueshëm. Për më shumë referohu:

<http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/> politika e revizionimit statistikor.

Diferencat statistikore misdis hyrje-daljeve të shtetasve Shqiptarë apo të huaj vijnë kryesisht nga:

- Ligjit nr.71/2016 “Për Kontrollin Kufitar”, neni 17 “Lehtësimi i verifikimeve Kufitare”, ku gjatë sezonit turistik apo fluksit të shtuar, në momentet e hyrjeve të shtetasve në kufi, nuk regjistron shtetasit në hyrje;
- Procedurat lehtësuese që aplikohen për banorët e zonave kufitare të cilët kalojnë kufirin për arsye të aktivitetit të tyre tregtarë, kur kalojnë disa herë brenda ditës, nuk regjistrohen në hyrje;
- Dy-shtetësia që zotërojnë një pjesë e mirë e Shqiptarëve të cilët në momentin e kalimit të kufirit mund të deklarojnë shtetësi të ndryshme në dalje nga ajo në hyrje, etj.